



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

DKR P.nr.31/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët profesionist Lumturije Muhaxheri – Kryetare, Sami Sharaxhiu dhe Violeta Hysaj Rugova – anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kernja, në lëndën penale ndaj të akuzuarit L. A. nga fsh....., Komuna, për shkak të veprës penale të vrasjes të mbetur në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së e të ri cilësuar në shqyrtim gjyqësor në veprë penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP-I.nr.99/18 të dt.21.11.2018, në seancat e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur nga dt. 06.07.2020 e gjere me datë 08.02.2021, në praninë e Prokurores së Shtetit Sahide Gashi , të akuzuarit, L. A. dhe mbrojtësit të tij av. H. M. nga Prishtina sipas autorizimit, të dëmtuarit U. I. dhe përfaqësueses së autorizuar të tij av A. K. nga Prishtina sipas autorizimit , me datë 08.02.2021 murr dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.09.2021 e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L. A. , i lindur me, në, ku ka edhe vendbanim të përhershëm Rr nr.52, i biri i E. dhe nënës K. , e gjinisë S. , ka të kryer shkollën e mesme , i pa punë- miret me punë bujqësore, i martuar babë i tre fëmijëve , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me parë kinse i pa dënuar , në paraburgim ka qene nga dt. 10.10.2018 e gjere me dt.10.12.2018 , kurse në arrest shtëpiak nga dt.10.12.2018 e gjere me dt. 11.10.2019.

ESHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt.10.10.2018, rreth orës 17: 30 minuta, në Fshatin, Komuna, pikërisht në livadhet e R. M. U., për shkak të mosmarrëveshjeve që kishte babai i të akuzuarit me të

dëmtuarin U., nga shkaku se i njëjti po ia dëmtonte ne vazhdimësi frytet ne livadhin qe e kishte marr me qira, duke i lëshuar lopët ne të, i akuzuari L. me dashje, i shkaktonte lëndime të lehta trupore të dëmtuarit U. I., në atë mënyrë që pasi i akuzuari tani i dënuari E. i tregon se i dëmtuari U. i kishte thënë veç po i qoj gratë në shtëpi dhe po kthena me u marr vesh, pasi i dëmtuari U. i shoqëruar me djalin e tij, këtu dëshmitarin Y. arrijnë ne vendin e ngjarjes, ku Y. thërret disa herë “o E., o E.”, i akuzuari se bashku me babin e tij dalin nga një mexhë, i akuzuari L. , fillimisht i drejtohet te dëmtuarit me fjale „ pse ti po ma kërcënon babën,, duke tentuar qe ta godas te dëmtuarin te cilit i del përpara dëshmitari Y. , qe ta pengoj te njëjtin dhe pas kësaj deri sa dëshmitari Y. ishte duke u marr me babain e te akuzuarit - E. , i cili kishte ngrit hunin duke tentuar ta godas te dëmtuarin, i akuzuari L. e shfrytëzon rastin duke shkuar disa hapa pas, dhe me pistoletën M-57, te kalibrit 7.62 mm, shtënë një here ne drejtim te dëmtuarit U. , duke e qëlluar ne regjionin e sipërm te kofshës se këmbës se majtë, duke i shkaktuar lëndime te përshkruara me afër si ne raportin e ekspertizës mjeko ligjore DD me nr. reference 01/2018 dt.26.10.2018, e te plotësuar me dt.18.09.2019, ku për pasojë i dëmtuari bie pa ndjenja ne toke, kurse i akuzuari largohet nga vendi i ngjarjes.

-me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 41, 45, 46, 73, 83, nenit 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së, nenit 365, 366, 450, 463 par.2, të KPPRK, të akuzuarin, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt.10.10.2018 e gjere me dt.10.12.2019 dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt.10.12.2018, e gjere me dt.11.10.2019, gjë që dënimi i shqiptuar të akuzuarit përputhet me kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak

I akuzuari L. , obligohet në pagimin e shpenzimeve te procedurës penale shumen prej 100 njëqind euro dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumën prej 50 € (pesëdhjetë) euro , kurse në emër të taksës së programit për kompensimin e viktimave obligohet të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë) euro, te gjitha këto ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzën PP-I.nr.99/18 të dt.21.11.2018, kundër te akuzuarve, L. A. nga fsh....., Komuna, për shkak të veprës penale të vrasjes të mbetur në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja ne pronësi kontroll apo posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, dhe te akuzuarit E. A. nga fsh....., Komuna, për shkak te veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-se.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate P nr.97/18 te dt.11.11.2019, i akuzuari L. A. është shpall fajtor për shkak te veprës penale të vrasjes të mbetur në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja ne pronësi kontroll apo posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, dhe është gjykuar , me dënim burgu ne kohëzgjatje prej 2 dy vitesh ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt.10.10/2018 e gjere me dt,10.12.1019 dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt.10.12.2019 e gjere me dt.11.10.2019 kurse për veprën penale nga neni 374 par.1 te KPRK-se, me dënim me gjobë në shumë prej 700 € (shtateqindë) euro, të cilën shumë është detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje, prej 35 (tridhjetepesë) 35 ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzet) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg. Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues: konfiskimi i pistoletës M-57, te kalibrit 7.62 mm me numër serik D34869, prodhim YU. Kurse i akuzuari E. A. është shpallur fajtor për shkak te veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-se. dhe është gjykuar me dënim me burg ne kohëzgjatje prej 2 dy muaj ne te cilën dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt.10.10.2018 e gjere me dt.10.12.2018.

Me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit në Prishtinë PAKR nr.628/19 datës 14.02.2020 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e prokurores dhe përfaqësuesit te autorizuar te palës se dëmtuar dhe mbrojtësit te akuzuarit L. A. , kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Peje DKR.P nr.97/18 te datës 11.10.2019 përkitazi me veprat penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK për te akuzuarin L. A. dhe veprës penale te kanosjes nga neni 185 par..2 e lidhur me par.1 te KPRK për te akuzuarin E. A. është vërtetuar, kurse me aprovimin e ankesës se mbrojtësit se akuzuarit L. A. por edhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi ne fjale ne raport me veprën penale vrasje e mbetur ne tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 te KPRK për te akuzuarin L. A. anulohet dhe çështja i është kthyer ne rigjykim dhe ne rivendosje.

Andaj gjykata rishqyrtimin gjyqësor e ka mbajtur për te akuzuarin L. A. për shkak te veprës penale te vrasjes ne tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 te KPRK-se.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit PP-I.nr.99/18 të dt.21.11.2018, në seancën e rishqyrtimit gjyqësor, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 325 të KPPK-se, të akuzuarit i ka ofruar mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. I akuzuari L. A. ne shqyrtim gjyqësor për veprën penale të vrasjes e mbetur në tentativë mbetet ne tersi pranë deklarimit te tij ne seancën fillestare dhe shqyrtim paraprak lidhur me fajësinë duke mos mohuar veprimet e tija te përshkruara me afër si nen pike I te diapozitivit te aktakuzës por duke e kundërshtuar kualifikimin juridik, andaj me qene se i akuzuari nuk e pranoi fajësinë për te gjitha pikat e aktakuzës, Gjykata shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi me procedurën e provave.

Prokurorja e Shtetit Sahide Gashi në fjalën përfundimtare ka deklaruar , se mbetet ne tersi pranë fjalës përfundimtare te dhënë ne shqyrtim paraprak ku me të gjitha provat personale dhe materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mire se i akuzuari L. A. me datë 10.10.2018 rreth orës 17:10 min, në fshatin K me dashje ka tentuar ta privoj nga jeta personin tjetër, dhe atë këtu të dëmtuarin U. I., kjo gjendje faktike është vërtetuar nga deponimi i te dëmtuarit U. I. dhe Y. I. te cilit pos tjerash

kane deklaruar se i akuzuari E. A. për një periudhë të gjatë po ia dëmtonte të mbjellat në livadhin e tij, duke i lëshuar lopët, përkundër tërheqjes së vërejtjes nga ana e tij, fakt ky i cili nuk është kontestuar nga te akuzuarit ashtu qe ditën kritike deri sa po kalonte me familjarët e tij, kishte vërejtur të akuzuarin E. i cili kishte futë lopët prapë në livadhin e tij dhe i kishte thënë se sa t'i dërgoj në shtëpi familjarët, do të kthehet për tu marr vesh, dhe se E. ne këtë rast kishte qenë vetëm, mirëpo me gjasë i akuzuari E. këtë e ka marr si kërcenim, meqë vet ishte pajisur me hu, kurse ne anën tjetër në ndërkohë për këtë e kishte njoftuar edhe djalin, këtu të akuzuarin L. , i cili ishte pajisur me armë, mirëpo ajo që gjithashtu e pranojnë të akuzuarit është fakti se i dëmtuari dhe djali i tij Y. i i cili sa kishte mbri në shtëpi në ndërkohë nga puna kur kishte vërejtur babin U. nervoz i cili po kthehej për tu marr vesh me E. dhe i kishte treguar, e ky ishte ofruar për t'i bërë shoqëri, **asnjëri prej tyre**, siç shprehen te akuzuarit **-nuk kishin pas asgjë në dorë**, e këtë e konfirmon edhe dëshmitari Y. , dhe pasi takohen e pas fjalosjes mes tyre, i akuzuari L. nxjerr nga brezi revolen dhe me dorëz të saj tenton ta godas të dëmtuarin U. , ku ndërhyt Y. i, e pastaj edhe i akuzuari E. e ngritë hurin për t'i rënë U. s në kokë, Y. i e kapë për duar për ta penguar dhe në atë moment vëren L. in që pasi shkon disa hapa pas ia drejton armën të dëmtuarit U. , mirëpo ai me gjithat shtënë duke e goditur në regjionin e sipërm të kofshës së këmbës së majtë, dhe kur vërejnë se i dëmtuari U. bjen në tokë, që të dy të akuzuarit ikin nga vend i ngjarjes , këto dëshmi kane mbështetje ne te gjitha provat materiale te administruara ne shqyrtim gjyqësor duke shtuar ne këtë shqyrtim qe dëshmitari Y. e ka penguar te akuzuarin L. deri sa ai ka gjuajt ne drejtim te dëmtuarit. Sipas prokurorisë pretendimet e mbrojtësit se qëllimi i te akuzuarit ka qene qe te dëmtuarit ti shkaktoi lëndime te lehta trupore nuk kane mbështetje ne asnjë prove te administruar nga se i akuzuari nuk kishte marr armën qe ta frikësoj e as për ti shkaktuar lëndime te lehta trupore te dëmtuarit , nga se po te ishte kështu ai do ta merrte ndonjë hu si babai i tij apo diçka tjetër e jo armen . Ne raport me pretendimin e mbrojtësit se i akuzuari sikur ta kishte qëllimin ta vriste këtë do ta bënte se ne revole kishte edhe shtate plumba , prokurori deklaroi se kjo rrethane nuk guxon te interpretohet ad hoc si rregull i përgjithshëm për te gjitha rastet , nga se jo rastësisht ligji thotë se secili rast është i veçantë dhe duhet vlerësuar ne lidhje faktike e logjike me secilën prove , si dhe ne lidhje me njëra tjetrën.

Andaj Prokuroria mbetet në tërësi si në aktakuzë për këtë pike , si dhe të gjitha propozimeve në te, i propozon Gjykatës që i njëjti te shpallët fajtor dhe te dënohet sipas ligjit

Përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar av. Albana Kelmendi, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi, fillimisht e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe meqë prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare i potencoi të gjitha provat të cila lidhen me përgjegjësinë penale të akuzuarit, si përfaqësuese . e palës së dëmtuar, do të deklarohet lidhur me kërkesën pasurore juridike dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Ashtu siç ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor parashtrojnë kërkesën pasurore juridike nga i akuzuari si kryes i veprës penale, mirëpo për shkak të ekonomizimit të procedurës dhe mos zvarritjes së çështjes kërkojnë nga Gjykata që lidhur me këtë kërkesë të udhëzohen në kontest civil.

Ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rëndues i dëmtuari përmes të autorizuarës së tij dhe sa i duket i akuzuari asnjëherë nuk ka shprehur pendim për veprën e kryer dhe në asnjë moment gjatë procedurës trupi gjykues nuk do të gjej ndonjë element lehtësues në favor të akuzuarit,

përkundrazi vetëm rrethana rënduese, andaj e lusin gjykatën që me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ti përcaktoj një dënim më të ashpër nga se nuk do të përmbushej qëllimi i dënimit të prevencionit individual dhe real.

I dëmtuari U. I., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: se pajtohet me fjalën përfundimtare të përfaqësues së autorizuar, tjetër nuk ka çfarë të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati Haxhi Millaku, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se pas fjalës përmbyllëse të prokurores si në pjesën e shkruar dhe në atë verbale, si mbrojtës i L. A. të cilit akuza e Prokurorisë i vë në barrë veprën penale të vrasjes në tentativë të paraparë me nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së(sipas pikës 1 të akuzës) , ku prokuroria pretendon sidomos në rrethana ku thuhet se ka dashje, janë formësuar elementet e figurës së veprës etj. Mbrojtja deklaroi se çuditërisht nga vetë fjala përfundimtare të cilën e mbështetë prokurori e paraqitur në shqyrtimin e parë , dhe e cila është konstatuar edhe me aktgjykimin e po kësaj gjykate, se nga prokuroria është hequr fjalia “dashja eventuale”, këtë fakt apo këtë institut e vërtetojnë në rikonstruimin e vendit të ngjarjes i dëmtuari U. I. dhe djali i tij Y. i, (sipas CD-së) në vendin e ngjarjes, ku si njëri ashtu edhe tjetri, në pyetje të mbrojtjes sipas audio dhe video incizimit vërtetohet edhe fakti vendimtar ku deklarohet se L. A. , nga distanca e përshkruar në një mënyrë apo tjetër (dallojnë) distancat, sipas të dëmtuarit dhe dëshmitarit “**po të dëshironte L. A. , ka mundur të vazhdoj të gjuaj dhe ka mundur të na vras si njërin ashtu edhe tjetrin sepse asgjë nuk e ka penguar kur ka shtënë një herë**”...?

Mbrojtja konsideron se edhe vetë përf. i akuzës e vërteton faktin e pamohueshëm se nuk është vetëm qëndrim i mbrojtjes por edhe provat në shkresat e lëndës që përshkruajnë corpus delikt (armen me disa fishek), e dorëzuar në Stacion Policor Istog. Këto prova dhe ky element subjektiv i L. A. , si dhe natyra e lëndimit mbi bazën e ekspertizave qoftë fillestare qoftë të plotësuara me vonë, vërtetojnë natyrën e lehtë të lëndimeve me pasoja të përkohshme, prandaj në raport me Kodin Penal figurën e veprës, elementet qenësorë, provat dhe faktet materiale dhe verbale na qojnë në të vetmin konkludim se kemi të bëjmë me vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 (apo 188 par.1 lidhur me par 2 të KPRK-së).

L. A. , nuk është person që ka ndonjë të kaluar kriminale, nuk është person që ka shkuar në vendin e ngjarjes me çfarëdo qëllimi për ta dëmtuar, sulmuar apo rrezikuar jetën dhe trupin. Nga rikonstruimi u vërtetua fakti se përveç fjalisë siç e tha edhe vetë prokuroria kur thotë i dëmtuari “duke ju drejtuar E. , pritëm se tash vi dhe merremi vesh”, nuk ka koment tjetër përveç kanosjes së drejtë për drejtë, me elemente që po shkojnë të përgatitem dhe të vij të qëroj hesape, kjo arsyetohet me rrethana se përse nuk erdhi vetë i dëmtuari pasi që mosha e dëmtuarit dhe dëmi i shkaktuar nga E. A. , kërkon një stabilitet të merrësh vesh në mes tyre për dëmin që ka pretenduar, mosha e tyre dhe mbi të gjitha raportet familjare që kanë një lidhje të largët nipa me dajë), fakte të pamohueshme, sikurse këto a është dhe rrethanë se U. I., e mori edhe të birin i moshës së re, nuk ka përgjigje tjetër përveç qërim hesapësh, në vendin e ngjarjes u vërejt distanca se ku e kanë lënë automjetin i dëmtuari I., e kjo distancë ishte hiq më pak se 200-300 metra, ku kishte shkuar për kinse tu takuar me E. A. , prandaj edhe fakti se kush në drejtim të kujt shkojnë paraqet specifikat që nuk janë kontribut i L. dhe E. A. , duke mbështet edhe fjalën e tij përmbyllëse të herës së parë, i propozoj gjykatës se në qoftë se Gjykata, në situatë më të pafavorshme për të mbrojturin e tij nuk e akcepton propozimin e mbrojtjes se L. A. , ka vepruar

në rrethana të mbrojtjes së nevojshme, apo tejkalimit të kufirit të kësaj mbrojtje, për hire të proporcionit (armës së zjarrtë), atëherë rasti më i pafavorshëm për të mbrojturin e tij do të ishte lëndim i lehtë trupor në rrethana lehtësuese qëllimi i shtënies me armë që ti largoj U. I.n dhe Y. I. , nga sulmi që vazhdonte ndaj prindit të tij E. A. , dhe në këtë kuptim i propozon gjykatës, me qenë se i mbrojturi i tij ka qëndruar në paraburgim nga dt.10.10.2018, deri me dt.10.12.2018, dhe në arrest shtëpiak nga kjo datë deri me dt.11.10.2019, që i bie një vit, e lut Gjykatën, që edhe në aspektin e preventivës dhe represives kjo masë e paraburgimit përkatësisht arrestit shtëpiak, do ti arrinte efektet e qëllimit të dënimit dhe konsideroj se do të justifikohet si përgjegjësia, si pasoja e shkaktuar ashtu edhe rrezikshmëria e veprimeve të mbrojturit të tij , gjithnjë konsideron se Gjykata do ti merr parasysh faktet dhe provat që janë në shkresat e lëndës por, sidomos sugjerimet e Gjykatës së Apelit, e cila përveç veprimeve që Gjykata e shkallës së parë në përpikëri i ka eliminuar, gjithashtu edhe vërejtja që ka qenë e lidhur me dispozitivin e akuzës përkatësisht në kuptim të identitetit dhe subjektivitet të akuzës në raport me provat e administruara.

I akuzuari L. A. , në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se pajtohet në tërësi me fjalën e mbrojtësit të tij, tjetër nuk ka çfarë të shtoj.

I akuzuari L. A. , në raport me veprën penale të vrasjes në tentativë , ne polici dhe ne shqyrtim gjyqësor dhe ne rishqyrtim gjyqësor , shfrytëzoi te drejtën dhe mbrojtjen e tij e dha ne heshtje duke shtuar se mbetet ne tersi pran deklarimit te dhënë në prokuroi dhe ne deponimin e tij ne rikonstruimin e vendit te ngjarjes, te cilat deklarime janë administruar si prova ne këtë shqyrtim, cili mes tjerash ka deklaruar, se këtu te dëmtuarin dhe dëshmitarin Y. i njeh nga lindja nga se janë fqinje te dajave te tij dhe para rastit raportet i kane pasur shume te mira. Sa i përket ditës kritike deklarone qe se bashku me babanë e tij i kane nxjerrë lopët me i kullot, por i ka vërejtur se disa prej tyre kane dal ne livadhin e U. s, sa ka njohuri pas orës 4 pasdite ka shku babai i tij dhe pasi qe ja ka vërejt qehren dhe e ka pyet se çka ki, ai i ka tregu se kaloi U. me rob kur i pa lopët ne livadhin e tij dhe i ka thënë se po i qoj rob dhe po kthena , pas 4-5 minuta e ka vërejt qe erdh U. me një Xhip vet i treti me Y. in dhe një nip te tij 15-16 vjeçar, kane zbrit nga vetura dhe erdhën ne livadhin ku ishte ky me babin, është nis ne drejtim te U. dhe i njëjti i ka thënë hajde se erdhëm me u marr vesh, ia ka zgjat dorën Y. it dhe janë përshëndet kur ia ka zgjat dorën U. s i tha jomë ardh me u marr vesh me ju, ju q....nenën, menjëherë e ka nxjerr sprejin te cilin ia ka qit këtij dhe babait, dhe pasi ka vërejt se Y. i e ka kap për dore babain e tij E. , ky pastaj është largu mbas e ka nxjerr armën dhe e ka gjuajt U. n jo me vra por me tut se me pas dashtë me vra ka pas mundësi se ne allti i kishte edhe 7 plumba. Për veç sprejtit U. dhe Y. i nuk kane pasur diçka tjetër ne dore. Pasi qe U. ia ka qit sprejin ne sy ka gjuajt veç ne toke se si e ka kap plumbi nuk ka njohuri, U. pasi e ka hargju sprejin ka nxjerr diçka nga xhepi i djathte i pantallonave a ka qene brisk apo diçka tjetër nuk ka njohuri kurse për Y. in edhe një here deklarone se nuk i ka vrenjtë asgjë. Armen gjithmonë e ka mbajt me vete dhe te njëjtën ia ka dhënë gjyshi për te cilën nuk kishte pas leje. Sipas te akuzuarit para rastit raportet i kane pas te mira ku vjet nga U. ia ka ble frytin e te gjitha livadheve qe i ka pas.

Gjate rikonstirimit te vendit te ngjarjes i akuzuari përveç tjerash deklaroi se kur i dëmtuari U. dhe dëshmitari Y. kane arritur ne vendin e ngjarjes dhe ky i fundit ka filluar duke thirr “o E., o E.” dy here, ka qene ne anën veriore te livadhit ku ka ndodhur ngjarja .I akuzuari shpjegon se ne momentin kur ka vërejtur të dëmtuarin U. dhe dëshmitarin Y. ka qenë diku 4 metra larg ku

është vendi “pellgu i gjakut”, ata kanë qenë duke i prit aty, ju ka zgjatë dorën Y. it i njëjti ia ka zgjat kurse U. jo por e ka nxirr sprejin dhe ju ka qit në fytyrë. Pastaj derisa ishte në krah të E. , Y. i e ka kap babën kurse ky ka kalu në ane të majtë të E. , sipas të akuzuarit vendi ku e ka gjuajt të dëmtuarin prova nr.1 pellgu i gjakut dhe vendi siç pretendon i akuzuari ku e ka nxjerr revolen dhe ka gjuajt është 4 m e 4 cm,(matja është bërë nga krim teknika), ka gjuajt për toke, nuk ka gjuajt me qellim me vra ., **dhe ky kur ka gjuajt për toke Y. i ka qenë duke pengu babain e tij – e ka kap për krish** , ku ka ra plumbi nuk ka njohuri , kurse i dëmtuari ne vendin ku ishte pellgu sipas te akuzuarit ka arrit pasi ju ka qit sprej, i dëmtuari ka shkuar pas kah ana e majte dhe pastaj te njëjtën e ka fut ne xhep .Pasi ka gjuajtur se bashku me babain e tij janë larguar nga vendi i ngjarjes ne drejtim te livadhut nga kane hyre. **I njëjti shton se nga askush nuk është penguar gjate qitjes me arme , ka mujt me gjuajt nga se i kishte edhe 7 fishek në revole, shpreh keqardhje pe rastin qe i ka ndodhur.**

Gjykata ne rishqyrtim gjyqësor i ka nxjerr te gjitha provat e duhura dhe pas vlerësimit te tyre te gjithanshëm, secilës veç e veç e ne lidhje reciproke me provat tjera komfor nenit 361 par.1 dhe 2 te KPPRK dhe pas vlerësimit te tyre vërtetoi gjendje faktike te përshkruar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi..

Gjykata ne shqyrtim gjyqësor administroi këto prova mbrojtja e te akuzuarit ne te gjitha fazat e procedurës penale, ne rishqyrtim gjyqësor dhe ne rikonstruimin e vendit te ngjarjes , deponimi i te dëmtuarit U. I. dhe dëshmitarit Y. I. ne te gjitha fazat e procedurës ,ne rishqyrtim gjyqësor dhe ne rikonstruimin e vendit te ngjarjes , sipas propozimit te mbrojtësit ka dëgjuar dëshmitarët F. H. , H. B. , S. M. , Dr. M. Z. dhe K. V., dhe ne rishqyrtim me pëlqimin e palëve janë lexuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, janë lexuar, raporti i hetuesit Sh T. i dt. 10.10.2018, raporti i oficerit rreshter S. M. me nr.ID-sëP.K#0283 dt.10.10.2018, raporti i oficerit F. B. me nr.ID-sëP.K#7170 dt.10.10.2018, raporti i oficerit F. H. , me nr.ID-së P.K#3672 dt.10.10.2018, raport i oficerit M. F., me nr.ID-së P.K#3918 dt.10.10.2018, raporti mbi ekzaminimin e vendit të ngjarjes së bashku me foto-album dhe skica e vendit të ngjarjes, raporti i Spitalit të Përgjithshëm Pejë-Emergenca me numër protokolli 20843 dt.10.10.2018, për të dëmtuarin , fletë-lëshimi nga Spitali i Përgjithshëm Pejë, me nr.protokoli 7846 i dt.16.10.2018, për të dëmtuarin, lexohet akt ekspertimi mjeko ligjor nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore Prishtinë DD me nr.reference 01/2018 dt.26.10.2018, plotësimi i mendimit te ekspertit mjeko ligjor Dr.V. H. dt.18.09.2019, ekzaminimi mjekësor për të akuzuarin L. A. me numër të amzës 4023 të dt. 10.10.2018 e lëshuar nga Dr. M. Z.. Është lexuar procesverbali në tërësi i shqyrtimit paraprak dt.07.05.2019, si dhe ai i dt.13.06.2019, është lexuar përgjigja e ekspertit të balistikës I. K. dt.24.08.2020, kryer me urdhër të Gjykatës P.nr.31/20 dt.04.08.2020, si dhe plotësimi i të njëjtit nga eksperti pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes, është lexuar procesverbali i rikonstruimit të vendit të ngjarjes dt.19.11.2020,lexohet raporti plotësues i Njesisë së Forenzikës dhe foto dokumentacioni gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes dt.20.12.2020, dëgjohet një CD me video incizime e kryer në rikonstruimin e vendit të ngjarjes.

Sipas propozimit te përfaqësueses se autorizuar e palës së dëmtuar avokatja A. K. , janë lexuar, raportit mjekësor për të dëmtuarin U. I. nga Spitali i Përgjithshëm Pejë me nr. regjistri 621 dt.16.11.2018, lëshuar nga Dr.S. B. , raporti i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë me nr. regjistri 10983 68109 dt.19.10.2018, lëshuar nga Dr.S. B. , raporti i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë me nr. regjistri 11994-4333 dt.16.11.2018 lëshuar nga Dr.M. B. neurolog-psikiatër, rezultatet nga analizat dt.20.10.2018 Klinika “.....” dr.D. G. - bio kimiste, raporti i Spitalit të Përgjithshëm në

Pejë me nr. regjistri 11533-5908 dt.26.11.2018, raporti i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë me nr. regjistri 1770 dt.26.11.2018, Dr.I. G. – Oftamologe, Konkluzioni nga EMG lëshuar nga Dr.V. K. -neuropsikiatër, vërtetimi nga Qendra balneare –Peshkopi Republika Shqipërisë me nr.protokoli 4.12 dt.06.12.2018, mjeku kurues M. P., konfirmimi për terapi te kryer nga Klinika e fizioterapisë “.....” dt.16.12.2018-Republika Shqipërisë, dhe është shiqu edhe ne foto dokumentacionin e shkresave te lendes .

Nga raporti mbi ekzaminimin e vendit të ngjarjes së bashku me foto-album dhe skica e vendit të ngjarjes, të dt. 10.10.2018, gjykata ka vërtetuar, se ngjarja ka ndodh me dt.10.10.2018 ne fshatin Komuna , pikërisht në livadhet e R. S. M. rreth orës 17:30 min ku pas një fjalosje në mes të dyshuarit dhe viktimës i dyshuari ka shtënë me armë në drejtim të viktimës i cili është plagosur dhe fillimisht është dërguar në Shtëpinë e Shëndetit në Istog e pastaj është dërguar në Spitalin Rajonal në Pejë . Në vendin e ngjarjes janë gjetur dëshmitë të evidentuar me # 1 pellg me ngjyrë të kuqe me dimension 46 cmX44cm qe është dyshuar te jetë gjak dhe dëshmia # 2 një gëzhgjë e cila është gjetur në distancë 6.83 cm nga pellgu.

Nga raportet policore te hetueseve, Sh T. , S. M., F. B., M. F. të gjitha të dt. 10.10.2018, gjykata ka vërtetuar, se me dt. 10.10.2018 rreth orës 17.30 min ne fshatin te pikërisht ne livadhet e R. S. M. kishte ndodhur një plagosje me arme zjarri, kështu qe një patrullë ka shkuar ne QKMF ne Istog ku ishte i dëmtuari U. I. i cili kishte një plage ne pjesën e epërme te këmbës se majte te cilit i është ofruar ndihma e pare mjekësore e me pas me autoambulance është dërguar ne Spitalin Rajonal ne Peje , një patrullë tjetër e hetuesve ka shkuar ne vendin e ngjarjes ku kane siguruar vendin e ngjarjes, dhe kanë vërejtur njolla gjaku, kurse një patrullë tjetër ka shkuar ne shtëpinë e te dyshuarve ku edhe janë arrestuar dhe është gjete arma dhe një karikator me shtate fishek me te cilën dyshohej se është kryer vepra penale e cila edhe është konfiskuar. Rasti pastaj ka kaluar ne Policinë Rajonale te Pejës, te cilit gjithashtu u janë përgjigjur vendit te ngjarjes dhe përveç pellgut te gjakut kane gjetur edhe një gëzhgjë. Sipas informatave te marra viktima ishte ne Spitalin Rajonal ne Peje kurse i dyshuari ishte arrestuar nga Policia e Stacionit Policor ne Istog. Për tu informuar për gjendjen shëndetësore te viktimës kane shkuar ne spital dhe nga mjeku kujdestar S. B. kane kuptuar se gjendja e tij është jashtë rrezikut për jete dhe sipas mjekut kishim te bënim me një plage te shkaktuar nga arma e zjarrit e qe predha kishte gene tej shkuese ne pjesën e sipërme te këmbës se majte , ku edhe është intervistuar i dëmtuari.

Nga raporti policor i hetuesit F. H. të dt. 10.10.2018, gjykata ka vërtetuar se pasi janë njoftuar lidhur me rastin, për te shtëna dhe te lënduar, se bashku me krim teknikun H. B. kanë shkuar në shtëpinë e të akuzuarit L. A. , të akuzuarin e kanë gjetur në shtëpi, është arrestuar gjithashtu është konfiskuar edhe arma e cila është dyshuar që është përdorur në rast. Gjithashtu ne raport është konstatuar se pasi qe i akuzuari është sjellë ne stacion i është ofruar ndihma e pare .

Nga raporti i Spitalit të Përgjithshëm Pejë-Emergjencia me numër protokoli 20843 dt.10.10.2018, për të dëmtuarin, gjykata ka vërtetuar se i dëmtuari është sjelle nga QKMF Istog i plagosur me arme zjarri ne këmbën e majte, kurse nga Fletë-lëshimi i Spitalit te Përgjithshëm Pejë, me nr.protokoli 7846 i dt.16.10.2018 po ashtu për të dëmtuarin, Reparti i Ortopedisë , rezulton se pacienti ne këtë repart ka qëndruar nga dt.10.10.2018 e gjere me dt.16.10.2018 ku i janë bere te gjitha analizat dhe është konstatuar diagnoza X93 Vulnus sclopetarium

transpenetrans pars proximalis femoris sin, dhe është trajtuar me medikamente te përshkuara me afër këtij flet lëshimi.

Nga akt ekspertimi mjeko ligjor nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore Prishtinë DD me nr. Reference 01/2018 dt.26.10.2018, i kryer nga eksperti mjeko ligjor V. H. e bazuar ne raportin dhe fletë lëshimin të cekura me larte është dhënë mendimi se te dëmtuarit i është shkaktuar plage me armë zjarri-plage tej shkuese te indeve te buta te regjionit te sipërm te kofshës se këmbës se majte , te shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit dhe si te tilla bëjnë pjese ne **DEMTIME TE LEHTA TRUPORE** dhe me dëmtim te përkohshëm te shëndetit. Nga plotësimi i mendimit te ekspertit mjeko ligjor Dr.V. H. dt.18.09.2019, e bazuar nga raporti dhe fletë lëshimi të cekura me larte dhe dokumentacionit plotësues mjekësor te dorëzuara gjykatës nga përfaqësuesja e autorizuar e palës se dëmtuar e te përshkuara me afër këtij plotësimi, nga eksperti është dhënë mendimi nen piken I me gjetjet dhe konstatimet si ne akt ekspertimin mjeko ligjor te dt. 26.10.2018 kurse ne piken II është konstatuar se sa i përket dokumentacionit plotësues , kemi te bëjmë me sëmundje patologjike te nervave periferike te gjymtyrëve te poshtme te trupit(nga se pacienti vuan edhe nga sëmundja e sheqerit tipi i pare) dhe te njëjtat nuk kane lidhje kauzale me plagën e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit.

Nga ekzaminimi mjekësor për të akuzuarin L. A. me numër të amzës 4023 të dt. 10.10.2018 e lëshuar nga Dr. M. Z., gjykata ka vërtetuar se pas arrestimit te dyshuarit i është bere një kontroll rutinë siç është rregull i policisë dhe pas ekzaminimit është konstatua se tensioni dhe zemra janë mire .

Nga përgjigja e ekspertit të balistikës I. K. dt.24.08.2020, kryer me urdhër të Gjykatës P.nr.31/20 dt.04.08.2020, si dhe plotësimi i të njëjtit nga eksperti pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes e duke vepruar sipas sugjerimeve te Gjykatës se Apelit, gjykata ka vërtetuar se eksperti duke u bazuar ne skicën e vendit te ngjarjes gëzhoja e gjetur dhe e fiksuar ne vendin e ngjarjes e që ka qene larg prej pellgut te gjakut ne distance prej 6.83 cm, kurse arma e përdorur ne vendin e ngjarjes ka qene Crvena Zastava model M-57e cila pas shkrepjes gëzhojat i hedh ne anën e djathte te qitësit dhe ne distance 2.7 deri ne 7.9 m si dhe duke marre parasysht sipërfaqen ku ka ndodhur ngjarja ka qene e bute dhe nuk kishte ndonjë objekt te fort (guri apo diçka te ngjashëm) si dhe bazuar ne distancën ne mes te akuzuarit dhe të dëmtuarit me rastin e gjuajtjes e të matur në rikonstruim të vendit të ngjarjes që ishte 4 m e 4 cm , e shtëna ka qene direkte dhe nuk ka pas mundësi rikoshetimi për shkak se toka është e butë nuk ka ndonjë objekt të fortë , dhe distanca në mes të akuzuarit dhe viktimës ishte shumë e vogël për të mund të shkaktohet plagë nga plumbi i rikoshetuar. Andaj bazuar ne këtë edhe pretendimet e te akuzuarit se ka gjuajt ne drejtim te tokës dhe nuk ka njohuri si është qëlluar i dëmtuari janë te pa bazuara.

Me rastin e vlerësimit te këtyre provave materiale gjykata ne tersi iu fale besimin për vete faktin se te njëjtat janë ne lidhmëni reciproke njëra me tjetrën dhe pjesërisht janë ne përputhje me deponimin e të dëmtuarit dhe dëshmitarit Y. I. te dëgjuar ne shqyrtim gjyqësor e qe do te elaborohen ne vijim.

Provat e prezantuara nga përfaqësuesja e autorizuar e te dëmtuarit e te administruara edhe ne këtë shqyrtim gjyqësor e te cekura me larte , gjykata i vlerëson si irelavante lidhur me çështjen

për vet faktin se sipas mendimit plotësues të ekspertit mjeko ligjor V. H. bazuar në këto dokumentacione mjekësore, tek i dëmtuari kemi të bëjmë me sëmundje patologjike të nervave periferike të gjymtyrëve të poshtme të trupit (nga se pacienti vuan nga sëmundja e sheqerit tip I) dhe të njëjtat nuk kanë lidhje kauzale me plagën e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit.

Gjykata i ka vlerësuar me shumë kujdes edhe deklaratat e të dëmtuarit të dhënë në polici, prokurori në shqyrtimin paraprak, në rishqyrtim gjyqësor dhe në rikonstruimin e vendit të ngjarjes dhe ka ardhur në përfundim se duhet të falet besimi këtyre deklaratave për faktet për të cilat nuk ka dilema, të njëjtat janë kuptimplote dhe bindëse për gjykatën, njëherë të njëjtat janë në harmoni edhe me deklaratën e dëshmitarit Y. dhe me provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor e të cilave gjykata iu ka falur besimin e plote.

Nga kjo dëshmi gjykata vërtetoi faktin se të akuzuarin e ka njohur para dhe pas luftës. Me familjen e të akuzuarit kanë pasur probleme edhe me parë sidomos një vit para rastit ka qenë një problem i madh ku babai i të akuzuarit E. i ka lëshu lopët në një pronë që dëshmitari e merr me qira qysh pas luftës prej personit T. K., dhe deri sa ishte në shtëpi e ka thirr një plak i katundit i quajtur U. M., i cili i ka thënë hajde se ta kanë dëmtuar krejt kollomoqin, kur ka arritur në livadh i ka vërejtur se lopët ia kishin prishë krejt kollomoqin, lopët nuk i ka prekur fare, me gjithat plaku i ka thënë se pse nuk po i heq lopët dëshmitari i është përgjigjur le të vjen e le të hjek vet E.. Pasi e ka thirr E., i njëjti jo vetëm që është ardh pas një ore, por është ardh edhe me një hu në dorë me të cilin i ka ruajtur lopët dhe ju ka kërcënuar “qysh U. i ke lënë lopët në kollomoq, me më cofë ti ke me mi pagu”, plaku i ka thënë grahi more lopët çka i keni bënë njërit

Sa i përket ditës kritike ka shkua me familjar në një livadh tjetër të cilin gjithashtu e kishte me qira për me mbledh kollomoq, U. ardhur përpjetë me traktor, në livadh në tokën të cilën edhe këtë e kishte me qira, e ka vërejt babain e të akuzuarit-E. me lope, e ka ndal traktorin dhe i ka thënë hajde mo zot ma keq çka u bo, dhe ju ka drejtuar E. prej traktorit me kon i yti nuk e bon dhe i ka thënë po shkoj në shtëpi mi qu robt dhe kthena me u marr vesh për mos me i lëshu ma lopët. Derisa ishte në shtëpi ka ardhur prej punës djali Y. i, i njëjti ka kërkua nga ai me shoqërua të dëmtarin që të shkojnë ta takojnë E. dhe të kërkojnë prej tij mos me i lëshu lopët me në token e tyre. Nga shtëpia e tij gjere ke livadhi largësia është mbi 1 km kurse largësia nga livadhi gjere në shtëpinë e të akuzuarve është mbi 2 km.

Kur kanë mbri në livadh lopët kishin dalur prej livadhit të tyre në livadhin e një fqinji që është polic të familjes M. kurse 4 lope i ka vërejtur në livadhin e tij, me vete nuk kanë pas asgjë, kanë qenë vetëm me duar në xhepa, i ka thënë djalit hajde mos ta thërrasim, por djali tha jo nuk bën kështu duhet me e thirr dhe mi thënë që ne të ardhmen mos të lëshoj lopët në livadhin e tyre, dëshmitari Y. e ka thirr O. E. dhe ky është përgjigjur, i dëmtuari dhe dëshmitari kanë dal prej livadhit të tyre në livadhin e familjes M., i akuzuari së bashku me E. kanë ardhur krah për krah, jo me qehre të keqe, L. i e ka nxjerr një arme kurse E. e kishte një hu në krah, kur L. i është avit 2 metra ju ka drejtua të dëmtuarit U. i thënë për çka ti po ma kërcënon babën për lopë e i thua heki lopët, pas kësaj ka tentua mi ra me arme në kokë por e ka penguar djali këtu dëshmitari Y., i dëmtuari i është përgjigjur vrajem se unë nuk kam ku me shku përtej pasurisë sime, në këto momente E. e ka ngrit hurin me i ra të dëmtuarit ku Y. i e ka penguar U. e kapur për krish, gjatë kësaj kohe L. i është shku anash dy –tri metra mbas dhe ju ka drejtua me fjale kthehu

se dua me te vrare ka vërejt se L. i ia kishte drejtuar armen ne drejtim te tij , e ka dëgjua një krisme dhe menjëherë ka ra ne toke, djali ka bërtitë “o të vrau” dhe djali e ka lëshuar E. dhe të dy këta në atë moment kanë ikur, djali e ka kap, i ka ardhur një far mundimi dhe pas kësaj nuk ka dite asgjë veç kur e ka pa veten në Spital te Pejës. Tregon se ka qenë i goditur në këmbën e majtë në lak të këmbës. E mohon qe ditën kritike te ketë pasur sprej duke shtuar se as nuk dine se çka është spreji. Afër livadhit te tij te akuzuarit nuk kane prone dhe arrat dhe livadhet për kullosë të përgjithshme të fshatit” lëshohen kur përfundojnë të gjitha punët në livadh dhe atë në majin nëntor. E vërtetë është se në livadh ka shkuar vetëm me djalin por në spitalin e Pejës kur ka ardhur për vizitë djali i djalit Endriti i ka treguar se kur ka ndodhur rasti ai ka qenë në vend të ngjarjes dhe i cili ka qenë dUke u kthyer në shtëpi nga vendi ku ishte dUke punuar dhe vetëm rastësisht e ka pa ngjarjen- respektivisht i njëjti nuk e ka pa ngjarjen por në rrugë janë takuar me djalin Y. in dhe nga aty ka kuptuar për ngjarjen. **Ne një pyetje te mbrojtësit se a kishte mundësin L. i me godit me arme edhe Y. in edhe ty prape a e ka penguar diçka , sipas te dëmtuarit me pas dashtë i akuzuari ka muajt me i vra 10 vet.**

Përveç te lartcekurave ne rikonstruimin e vendit te ngjarjes i njëjti ka deklaruar largësia prej ku ka qëndrua L. i nga viktima kur ka gjuajte me armë është 3.5 metra, dUke shtuar se mund te ketë dallim 2-3 m, **L. i ka pas mundësi me vra edhe Y. in .**

Gjykata nuk ia fal besimin pjesës se deponimit te tij kur ne shqyrtim gjyqësor deklaroi se kur kane arritur me djalin ne livadhin e tyre, 4 lopë i ka vërejtur në livadhin e tij kurse tjerat kanë qenë në livadhin e familjes M. , si dhe me rrethanat se fillimisht kur i akuzuari i është ofruar te dëmtuarit e ka godit me arme ne koke dhe se e vërteta sipas dëshmitarit është se kur është ofru L. i përveç qe i ka shajt me nene ka thënë “ ju vras si qenë të dyve” , për vete faktin kjo pjese e deponimit te tij jo vetëm qe është ne kundërshtim me vetveten por edhe ne kundërshtim me deponimin e dëshmitarit Y. , nga se ne polici dhe prokurori ka deklaruar se kur kane arritur te livadhi i tyre aty nuk kishin qene lopët e E. por te njëjtat kishin qene ne livadhin e familjes M. e qe kjo e fundit është ne përputhje te plote me deponimin e dëshmitarit Y. ne te gjitha fazat e procedurës penale i cili ka deklaruar se kur kane arritur ne livadhin e tyre, lopët kane qene ne livadhin e familjes M. , gjithashtu edhe rrethana “ **ju vras si qenë të dyve**” është ne kundërshtim me vet deponimin e tij te dhënë ne polici dhe prokurori dhe ne kundërshtim me deponimin e dëshmitarit Y. , me vet faktin se ne prokurori ka deklaruar se kur është ofru L. i ju ka drejtua me fjale kthehu se du me te vrare, kurse ne shqyrtim gjyqësor here thoshte **ju vras si qenë të dyve**” e here ju ka drejtua me fjale kthehu se du me te vrare, kurse dëshmitari Y. ne këtë drejtim ka deklaruar se E. i ka thënë L. it kur e ka nxjerr armen gjuaj e vraji te dyte. Gjithashtu edhe pretendimi i tij se i akuzuari L. fillimisht e ka godit ne kokë me qyk të armës është në kundërshtim me deponimin e dëshmitarit Y. ne të gjitha fazat e procedurës i cili ne këtë drejtim ka deklaruar se fillimisht të akuzuarit L. nuk i ka vërejte asgjë në dorë por kur ky e ka pengu të akuzuarin E. qe ta godas të dëmtuarin me hu e ka vërejt L. in kur armen e ka nxjerr nga shoka dhe ka gjuajt ne drejtim të babait të tij.

Nga deponimi i dëshmitarit Y. I. , gjykata ka vërtetuar këto fakte se te akuzuarit i njeh dhe me te njëjtit kane pas problem edhe para një viti nga se te njëjtit i lëshonin lopët ne livadhin e tyre. Ditën kritike pasdite rreth orës 5 është kthyer nga puna , dhe nga babai ka kuptua se E. i ka lëshuar lopët në livadh, dhe babai ka kërkua qe te shkojnë ne livadh dhe ta pyesin E. se pse po i lëshon lopët në livadhin e tyre, ne livadh kane shkuar me veture dhe kur kane arrit kane vërejtur

se E. i kishte hekur lopët prej livadhit te tyre dhe i kishte qit në livadhin e familjes M. , dhe ka thirr E. , E. , E. - tri herë, nuk ka dal por kur e ka thirr edhe njëherë te dy te akuzuarit kanë dal prej mexhës dhe kur kane ardhur E. kishte një hu ne dore kurse L. i nuk kishte pasur asgjë ne dore por ia ka nisë me u sha, dUke ju drejtuar babait pse po thua qe ti kem shti lopët ne livadh , pse i ke thënë babës hiqi lopët, L. i fillimisht iu ka afrua babait mi ra , i ka dal përpara me ndal L. in deri sa ishte dUke e mbajtur L. in , e ka vërejt E. qe e ka qu hunin me i ra babait dhe ne këto momente e ka leshu L. in dhe e ka kap E. për krish dhe deri sa ishte ne pozite anash me L. in, ka vërejte se e ka nxjerr një arme te zeze dhe ka gjuajt ne drejtim te babait dhe E. i ka thënë L. it “**Vraji**” , nuk e ka vërejt se ku e ka qellu me plumb por e ka pa babën të rrezuar, e ka kap para duarsh dhe ka vërejtur se dora i është ba me gjak e ka shti në veturë dhe e ka dërgua ne ambulat ne Istog e pastaj ne Spitalin e Pejës, derisa ishte dUke e bartur babën deri te vetura, E. i ka thënë L. it “hajde të ikim”. As ky e as babai i tij nuk kishin asgjë me vete, nuk është e vërtetë se kane pas gazë lotsjellës.

Përveç te cekurave me larte, ne rikonstruimin e vendit te ngjarjes ka deklaruar se babai ne momentin kur është godit me arme nga i akuzuari ka qene ne vendin e shënuar me provën 1 ku ka qene pellgu i gjakut, **ne momentin kur L. i ka gjuajt me arme ne drejtim te babait te tij nuk ka qene i penguar nga askush qe te gjuaj edhe me tej ka pas mundësi me gjujt e me vra edhe vete dëshmitarin**

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë se këtij dëshmitari gjykata ia fal besimin e plote nga se i njëjti ne te gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar njëjtë pa kurrfarë ndryshimi dhe këto deponime janë kuptimplote dhe bindëse për gjykatën, njëherë te njëjtat janë në harmoni edhe më deklaratën e te dëmtuarit U. dhe me provat materiale te administruara ne shqyrtim gjyqësor e te cilave gjykata iu ka falur besimin e plote. Gjykata dëshmisë se këtij dëshmitari nuk ia ka fal besimin vetëm lidhur me rrethanën kur i njëjti ka deklaruar se kur L. i e ka nxjerr armen E. i ka thënë „vraji, për vete faktin se kjo nuk ka mbështetje ne asnjë prove te administruar ne shqyrtim gjyqësor qoftë materiale apo personale.

Dëshmitarja Dr.M. Z., ne deponimin e saj ne shqyrtim gjyqësor paraprak e me pëlqimin e palëve te lexuar ne rishqyrtim gjyqësor , ka deklaruar se gjatë muajit tetor 2018 ka punuar në urgjencë te QKMF ne Istog dhe nderimin e ka pas nga ora 7 në mbrëmje gjer në ora 7 ne mëngjes, është Specialiste Gastro Hepatologe.Pretendon se është rregull i policisë mi sjellë personat kur kryhet ndonjë vepër për ekzaminim mjekësor, pra ekzaminimin fizik dhe shëndetësor, fizik shihet pamja a ka gjakderdhje apo goditje, të cilat janë kërcënuese për jetën e për të tjerat që ka nevojë udhëzohet për në spital. Dëshmitarja e konfirmon nënshkrimin dhe vulën e saj ne raportin e dt.10.10.2018, me nr.reference – amza 4023 dhe shton se sipas raportit shifet se është be ekzaminimi i këtu te akuzuarit L. A. , dhe dUke ju referuar raportit deklaroi se ne te ka konstatuar se tensioni ka qenë mirë, zemra mirë, mirëpo gjithnjë sipas kujtesës sytë i ka pas te skuqur , dhe është e vërtetë se gjate ekzaminimit te çdo pacienti ne raport duhet te shënohet çdo ndryshim që vëren te pacienti lëndim, mavijosje dhe ne raport te pacientit nuk është konstatuar ndonjë ndryshim dhe me qe kjo nuk është konstatuar ne raport dëshmitarja deklaroi se nuk është e sigurt a i ka pas sytë e skuqur, sipas dëshmitares sytë mundë ti skuqen gjithkujt nga tensioni alergjia etj. Si rregull kur pacientët i sjellë policia e bëjnë kontrollimin fizik të tensionit, fryma rejës, i parashtrohen pyetjet për sëmundjet e kaluara nëse paraprakisht ka vuajtur, terapinë, e shikojnë pamjen fizike të jashtme se a ka ndonjë plagë.

Nuk i kujtohet a ia ka kontrolluar sytë por ka mundësi ti ketë thonë motrës kontrolloja, dëshmitarja është e sigurt se pacienti nuk e ka përmendur mjetin prej çka ka mundur me ju skuq sytë respektivisht nuk ka përmendur kurrfarë spreji, por ka qenë si i mërzhitur. Ne raport nuk i ka shënuar kurrfarë medikamenti për gjendjen e tensionit dhe të rrahurat e zemrës edhe pse medikamentet nuk i shënojnë në raport, zakonisht nëse i japin shënohet diku tjetër, e nëse i ka jap qetësues pacientit L. e ka shënuar diku tjetër në një letër tjetër nga se në bazë të cekurave në raport nuk ka pas nevojë për ndonjë medikament tjetër. Si pacient L. A. nuk i kujtohet nga se kanë shumë raste dhe nuk mund ti mban ne mend.

Dëshmitarja K. V., ne deponimin e saj ne shqyrtim gjyqësor paraprak e me pëlqimin e palëve te lexuar ne rishqyrtim gjyqësor ka deklaruar se L. A. i kujtohet vetëm si rast qe ka ardhë ne ambulant nen përcjellje te policisë dhe kontakti i pare me L. in ka qene kur doktoresha i ka thënë me ja pastru sytë, nuk ka bisedu asgjë me të, vetëm e ka kryer punën e saj dhe ja ka pastruar sytë me “acua” - ujë i distiluar dhe ky pastrim ka zgjat 2-3 minuta, dhe përveç syve nuk i ka pastruar ndonjë plage tjetër , dhe ky veprim i saj pastrimi nuk është shënuar ne libra nga se ka mujt me u tejkaluar për shkak të punës, nuk i kujtohet nëse doktoresha i kishe shkruar ndonjë medikament. Është e vërtet qe si emër nuk e njeh L. in por si rast i kujtohet se ka qene si rast me i rende dhe atë dite është marre edhe me palën tjetër e cila ka qenë i plagosur.

Me rastin e vlerësimit te këtyre dy dëshmime, gjykata iu fal besimin për faktet te cilat janë vërtetuar dhe nuk ka dilema , për vet faktin se te njëjtat janë ne lidhje logjike njëra me tjetrën e respektivisht është ne përputhje te plote me raportin nga ekzaminimi mjekësor për të akuzuarin L. A. me numër të amzës 4023 të dt. 10.10.2018 e lëshuar nga Dr. M. Z., ne te cilin raport nuk ceket se i njëjti te ketë pasur problem me sy përveç qe dëshmitarja deklaroi se nuk është e sigurt a i ka pas sytë e skuqur apo jo dhe se pacienti nuk ka përmendur kurrfarë spreji apo mjeti, ne këtë drejtim dëshmitarja K. deklaroi se vetëm ja ka pastruar sytë me “acua” - ujë i distiluar dhe nuk cek nëse pacienti i kishte sytë e skuqur apo jo, këto dëshmi gjithashtu janë ne përputhje edhe me provat tjera materiale te elaboruara me larte e qe gjykata iu ka falur besimin e plote , nga se ne asnjë raport te policëve hetues nuk është ceku se i akuzuari është gjuajtur me gaz lotsjellës nga i dëmtuari, një herrit është edhe në përputhje me deponimet e te dëmtuarit dhe dëshmitarit Y. të cilit në këtë drejtim deklaroi se ditën kritike nuk kanë pasur asgjë me vete e as ndonjë sprej, çka i dëmtuari nuk ka njohuri se çka është spreji, nga e tere kjo gjykata vjen ne një konkludim logjik se te akuzuarit i është bere vetëm një kontroll rutinë qe i behet çdo te arrestuari – të ndaluarit nga se sikur se mjekja te kishte vërejtur se i njëjti kishte problem me sy siç deklaroi edhe dëshmitarja M. e njëjta do ta kishte konstatuar ne raport dhe do ta udhëzonte për shërim te mëtutjeshëm .

Dëshmitari H. B., ne deponimin e tij ne shqyrtim gjyqësor paraprak e me pëlqimin e palëve te lexuar ne rishqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se lidhur me rastin ne fjale ka marr informacion nga udhëheqësi i ndërrimit që në fsh....., ka të shtëna me armë zjarri dhe është një i lënduar, ne mungese te policëve i njëjti me kolegun hetues F. H. , kanë shkruar te shtëpia e dyshuarit ndërsa dy të tjerë kanë shkruar me siguru vendin e ngjarjes , me të arritur te shtëpia e të dyshuarit dyert e oborrit kanë qenë të hapura me qenë se e ka njohur E. A. , i është drejtuar me fjalët çka ka ndodhur dhe a jeni ju që keni shtënë me armë, thotë unë jo por djali..

Pasi te akuzuarit janë sjellë në stacion policor , me tutje me ta është marr njësitë reagues që janë në stacion dhe është në kompetencë të tyre që të arrestuarit ti dërgojnë te mjeku, por gjatë rrugës ju kanë thënë se ju kanë hedhë prej dhe këtë e ka thënë E.. Pas konsullimit me prokurorin me rast janë marr hetuesit Rajonal. Ka qenë edhe në vendin e ngjarjes ka vërejtur pellg gjaku, ka qenë livadh bari bukur i rritur dhe një gëzhgjë e cila është gjetur pasi ka ardhur krim teknika Rajonale e Pejës , tjetër gjë nuk ka vërejtur as stupc e as s prej . Personalisht nuk ka përpiluar raport edhe pse gjatë rrugës është biseduar lidhur me sprejin dhe te akuzuarit ja ka vërejt sytë e skuqur , arsyeja pse ska përpiluar raport është se te akuzuarin nuk e ka intervistuar dhe mos te dyfishohen raportet nga se me pas rasti ka kaluar në Njësinë Rajonale në Pejë.

Dëshmitari F. H. , në deponimin e tij në shqyrtim gjyqësor paraprak e me pëlqimin e palëve të lexuar në rishqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ka përpiluar raport për ngjarjen e dt.10.10.2018, dhe ky me krim teknikun H. B. ka qenë vetëm në shtëpinë e te dyshuarit e jo edhe në vendin e ngjarjes. Te dyshuarit i është ofruar ndihma e parë por, nga këta personalisht jo, por ndihma e parë ju është ofruar nga patrulla reaguese e Stacionit Policor Istog. Është e vërtetë se nga shtëpia të njëjtin e ka sjellë në stacion policor dhe gjatë asaj periudhe ka pas ankesa në sy, se po i djegin sytë sipas tij gjëja prej sprejit, pastaj e kanë lënë në stacion dhe me te është marr patrulla tjetër. Sipas dëshmitarit lidhur me ankesën e te dyshuarit duhet me i shenu në raport dhe në raportin e dëshmitarit është konstatuar se ju është ofruar ndihma e parë në shtëpinë e shëndetit në Istog. Te akuzuarin e njeh nga se i njëjti edhe me parë i ka pas do raste me palë tjera për çështje pronësie dhe në atë drejtim i ka njohur. Është rregull që çdo i dyshuar të dërgohet për kontroll mjekësor. Është e vërtetë se çdo informatë që e marrin duhet me e shënuar në raport, por këtë nuk e ka shënuar nga se patrullës tjetër ju ka thënë që duhet të dërgohet te mjeku për shkak se ka ankesa për sy. Me rast është marr Hetuesia Rajonale e Pejës.

Dëshmitari S. M. në deponimin e tij në shqyrtim paraprak e me pëlqimin e palëve të lexuar në rishqyrtim gjyqësor ka deklaruar se te akuzuarin L. e njeh si kumbarë, janë në fqinjësi, edhe me U. I., tokat i kanë afër dhe e njeh si bashkëfshatar. Ditën kritike ka qenë kujdestar dhe me të marr informatën është angazhuar dhe i ka njoftuar njësitet përkatëse me dal në vendin e ngjarjes, pasi vendi i ngjarjes ishte pikërisht në tokat e M. ve, toka e familjes së tij dhe e njihte mirë atë rejon, ka dalë në vendin e ngjarjes, së bashku me F. B. dhe një hetues për momentin emri nuk i kujtohet, në vendin e ngjarjes aty ka qenë pak gjak , nuk e kanë takuar askënd nga personat e implikuar në rast, me vonë kanë ardhur krim teknika e Stacionit Policor Pejë, dhe gjatë kryerjes së detyrës me mjete përkatëse e kanë gjetur një gëzhgjë.

Te akuzuarin e ka takuar diku pas orës 9 të mbrëmjes dhe me që ishte udhëheqës i ndërrimit ka biseduar me te dhe ka pas lotë në sy , ka pas ankesa që po i djegin sytë, gjëja se U. ju ka qit prej. Në vendin ku ka ndodhur ngjarja diku 70-100 metra larg është një tokë e familjes A. , por jo e familjes së L. A. , kurse familja I. e ka tokën në mexhë ku ka ndodhur ngjarja, përveç disa shenjave të gjakut dhe gomave të veturës nuk ka vërejtur asgjë tjetër asnjë mjet tjetër të rrezikshëm. Dëshmitari deklaroi se lidhur me veprimet e tija ka përpiluar raport dhe në këtë raport nuk e ka konstatuar informatën e marrë nga i dyshuari, se U. ja ka qit sprejin, pse nuk është shënuar është bere një lëshim por për këtë informatë i ka informuar njësitin patrullues dhe të njëjtin e kanë dërgu për kontrollë rutinë . Personalisht për këto informata i ka njoftuar H. B. dhe F. H. dhe se te njëjtit a i kanë njoftuar hetuesit Rajonal në Pejë tek te cilët ka kaluar rasti nuk ka njohuri por personalisht hetuesit Rajonal në Pejë nuk i ka lajmëruar.

Me rastin e vlerësimit të deponimeve të këtyre tre dëshmitarëve gjykata iu fali besimin lidhur me faktet e vërtetuara e për të cilat nuk ka dilema, nga se këto dëshmi janë në lidhje logjike me njëra tjetrën dhe janë në përputhje të plote me provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor të cilave gjykata iu fali besimin e plote respektivisht janë në përputhje të plote me raportet e përpiluara nga ana e tyre. Nuk iu fal besimin pjesës së deponimeve të tyre lidhur me deklarin e të akuzuarit me ankesat e tij me sy, se gjeja i kishte të skuqur dhe gjeja i njëjti paraprakisht është gjuajt me sprej nga i dëmtuari, për vet faktin se këto deklarime të dëshmitarëve janë në kundërshtim me raportet e përpiluara nga ana e tyre lidhur me rastin nga se këto rrethana nuk janë konstatuar në raport edhe pse është rregull i policisë se për çdo informate të marre duhet të përpilohet raport dhe të çeket decidivisht informata e sidomos edhe pse ishin në dijeni se fjala ishte për një rrethane të rëndësishme, që mund të ndryshoj gjendjen faktike apo edhe kualifikimin ligjor të veprës penale, një herit deklarimet e tyre në këtë drejtim janë në kundërshtim me raportin e vendit, skicën, dhe fotot e vendit të ngjarjes në të cilën nuk është konstatuar se në vendngjarje është gjetur ndonjë mjet i rrezikshëm respektivisht spreji, gjithashtu janë në kundërshtim edhe me deponimin e dëshmitarit Y. dhe të dëmtuarit U. të cilit në këtë drejtim kanë deklaruar se ditën kritike nuk kishin pas asgjë me vete, çak i dëmtuari U. nuk kishte njohuri se çka është spreji. Si përfundim i tërë kësaj në shkresa të lëndës përveç raportit të mjekut Dr M. Z. e cila u elaboruar me lartë nuk ekziston ndonjë raport tjetër mjekësor që të akuzuarit i është ofruar ndihma e pare për shkak të ankesave për sy.

Nga të gjitha provat e elaboruara me lartë gjykata përtej çdo dyshimi vërtetoi faktet e të cilat nuk janë kontestuese, se familja e të akuzuarit dhe të dëmtuarit janë njohur mes vete para dhe pas luftës, dhe gjere para një viti raportet i kishin të mira. Por këto dy familja kanë pasur probleme edhe me pare sidomos një vit para rastit ku familjaret e të akuzuarit i kanë lëshuar lopët në një pronë që dëshmitari e merr me qira qysh pas luftës prej personit T. K., e këto veprime i ka përsëritur në vazhdimësi gjere në ditën kritike.

Nuk është kontestuese se ngjarja ka ndodh me dt. 10.10.2018 rreth orës 17.30 min në Fshatin Komuna dhe se po atë dite deri sa i dëmtuari me familjare ishte dUke u kthyer në shtëpi nga një livadh tjetër të cilën gjithashtu e kishte me qira, ka vrenjtur se në livadhin e tij E. kishte lëshuar lopët në kollomoq, ku i dëmtuari i është drejtor me fjale ,, veç po i qoj gratë në shtëpi dhe po kthena mu marr vesh, nga shkak se i njëjti po ia dëmtonte në vazhdimësi frytet në livadhin që e kishte marr me qira, dUke i lëshuar lopët në të. pasi që i dëmtuari merr djalin e tij këtu Y. in që të shkojnë të mirën vesh me E. që mos të lëshoj me lopët në livadhin e tyre, kur arrijnë në vendin e ngjarje kanë vërejtur se lopët nuk kanë qene në livadhin e tyre por ishin aty afër në një livadh të familjes së M.. Nuk është kontestuese gjithashtu se E. i kishte treguar djalit të tij këtu të akuzuarit për fjalët që i dëmtuari i kishte thënë të njëjtit. Dëshmitari Y. ka kërkuar që të bisedoj me familjen e të akuzuarit që në të ardhme mos të lëshojnë lopët në livadhin e tyre, dhe ky i fundit për një moment ka filluar disa here të thërras o E.dhe kur ka thirë edhe një here, nga një mexhe kanë dalë i akuzuari së bashku me babain e tij, ku fillimisht i akuzuari L. nuk kishte asgjë në dorë gjithashtu nuk kishin me vete asgjë as i dëmtuari dhe djali i tij për veç E. që kishte një hu.

Nuk është kontestuese që i akuzuari L. i drejtohet të dëmtuarit me fjale,, pse ti po ma kërcënon babën dhe të njëjtit i kanë shkëmbyer disa fjale mes veti, fillimisht i akuzuari L. tenton që ta

godas te dëmtuarin por e pengon këtu dëshmitari Y. , pastaj deri sa dëshmitari Y. ishte duke u marr me te akuzuarin E. i cili kishte ngrit hurin me godit te dëmtuarin duke e kapur për krih i akuzuari L. shkon disa hapa pas dhe me pistoletën M-57, te kalibrit 7.62 mm”, cilën e kishte pas me vete e nxjerr nga shoka dhe nga një largësi prej 4 metra ka shtënë një here me arme ne drejtim te dëmtuarit U..

Nuk është kontestuese se i dëmtuari është qëlluar ne regjionin e sipërm te kofshës se këmbës se majte, dhe te njëjtit i është shkaktuar plaga nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit, dhe predha kishte qene tejshkuese te indeve te buta te regjionit te sipërm te kofshës se këmbës se majte , dhe si te tilla bëjnë pjese ne DEMTIME TE LEHTA TRUPORE dhe me dëmtim te përkohshëm te shëndetit e qe janë ne përputhje te plote me akt ekspertimin mjeko ligjor nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore Prishtinë DD me nr. Reference 01/2018 dt.26.10.2018, i kryer nga eksperti mjeko ligjor V. H. .

Nuk është kontestuese se tek i akuzuari pas një kontrolli rutinor nga mjeku kujdestar është konstatuar se tensioni dhe zemra janë mire , si dhe ne vendin e ngjarjes është gjete njolla gjaku dhe një gëzhjojë dhe përveç këtyre provave ne vendngjarje nuk është gjete ndonjë mjet tjetër i rrezikshëm.

Nuk është kontestuese se ne armën e të akuzuarit që është përdor ditën kritike kanë qenë edhe shtatë plumba dhe gjatë të shtënës në drejtim të viktimës i akuzuari nuk ka qenë i penguar nga askush dhe largësia e të akuzuarit dhe viktimës gjatë të shtënës ka qenë diku 4 m e 4 cm.

Gjykata e vlerësoj edhe mbrojtjen e të akuzuarit, dhe për faktet e deklaruara te cilat sipas gjykatës nuk kane dilema dhe mbështeten ne provat tjera te administruara ne shqyrtim gjyqësor , ia fali besimin e siç janë, se te dëmtuarin dhe dëshmitarin Y. i njeh nga lindja nga se janë fqinje te dajave te tij dhe para rastit raportet i kane pasur te mira. Sa i përket ditës kritike deklarun qe se bashku me babanë e tij i kane nxjerrë lopët me i kullot, por i ka vërejtur se disa prej tyre kane dal ne livadhin e U. s, sa ka njohuri ora diku ka qene rreth 4 pasdite ka shkua babai i tij dhe pasi qe ja ka vërejt qehren dhe e ka pyet se çka ki, ai i ka tregu se kaloi U. me rob kur i pa lopët ne livadhin e tij dhe i ka thënë se po i qoj rob dhe po kthena , pas 4-5 minuta e ka vërejt qe erdh U. me një Xhip , kane zbrit nga vetura dhe erdhën ne livadhin ku ishte ky me babin si dhe Y. it nuk i ka vrenjtë asgjë ne dore, se altin e ka nga gjyshi dhe gjithnjë e ka mbajt me veti .

Me rastin e vlerësimit te pretendimit te tij se kur i është ofruar te dëmtuarit i njëjti e ka nxjerr sprejin dhe ia ka qit këtij dhe babait te tij dhe kur te dëmtuarit i është hargjitur spreji i njëjti nga **xhepi i djathte i pantallonave ka nxjer edhe diçka a ka qene brisk apo diçka tjetër nuk ka njohuri**, këtij pretendimi te akuzuarit gjykata nuk ia fale besimin për vet faktin se është ne kundërshtim me te gjitha provat materiale dhe personale e te administruara ne shqyrtim gjyqësor respektivisht një pretendim i tille i te akuzuarit është ne kundërshtim me raportin e vendit skicën dhe fotot e vendit te ngjarjes ne te cilën nuk është konstatuar se ne vendngjarje është gjetur ndonjë mjet i rrezikshëm respektivisht spreji, gjithashtu janë ne kundërshtim edhe me deponimin e dëshmitarit Y. dhe te dëmtuarit U. te cilit ne këtë drejtim kane deklaruar se ditën kritike nuk kishin pas asgjë me vete çak i dëmtuari U. nuk kishte njohuri se çka është spreji.

Sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime të akuzuarit janë të orientuara në zvogëlimin apo ikjen e përgjegjësisë penale të tij, është mundur që veten ta paraqes në cilësinë e të dëmtuarit që sipas tij dhe mbrojtësit të tij, i njëjti paraprakisht ka qenë i sulmuar nga i dëmtuari me sprovë të cili ju ka gjuajt këtë dhe babait të tij, dhe kur e ka vërejt dëshmitarin Y. se ia ka kapur babin për krah ky shkon disa hapa pas e nxjerr revolen dhe gjuan për toke se si plumbi e ka kapur të dëmtuarin nuk ka njohuri, gjeja që i akuzuari në rastin konkret ka vepruar në mbrojtje të nevojshme.

DUKE vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit dhe pretendimin e mbrojtësit, nga aspekti i veprimit të mbrojtjes së nevojshme, gjykata jashtë çdo dyshimi, ka provuar se i akuzuari nuk ka qenë i sulmuar nga i dëmtuari dhe se këndejmi nuk mund të pretendoj në të drejtën e tij për tu mbrojtur që do ta bënte veprimin e tij juridikisht të lejuar, dhe kështu për derisa nuk ka sulm nuk mund të ketë as mbrojtje të nevojshme e as tejkallim të mbrojtjes, andaj nuk janë përmbushur elementet e domosdoshme për mbrojtjen e nevojshme të përcaktuara me neni 12 të KPRK.

Nga rezultati i provave të administruara dhe nga analiza dhe vlerësimi i secilës nga to veç e veç dhe në lidhmëni njëra me tjetrën, gjykata nuk ka aprovua kualifikimin juridik nga aktakuza të veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 178 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, nga se në rastin konkret gjykata nuk ka mund ta vërtetoj dashjen e të akuzuarit për privim nga jeta të dëmtuarin dhe këtë nga arsyet në vijim, nuk është kontestuese që i akuzuari ka gjuajt në drejtim të akuzuarit duke e qëlluar në pjesë jo vitale të trupit, në pjesën e sipërme të kofshës së majtë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme si dhe duke pas parasysh distancën në mes të akuzuarit dhe viktimës në momentin e gjuajtjes dhe faktin që i akuzuari pas të shtënës në pistoletën e tij kishte edhe 7 plumba e sidomos faktin se i akuzuari gjatë të shtënës nuk ka qenë i penguar nga askush që të vazhdoj të gjuaj edhe më tej, dhe në këtë drejtim i dëmtuari U. ka deklaruar se i akuzuari me pas dashtë ka pas mundësi ta vriste dhe dëshmitarin Y. apo edhe deri në 10 persona, gjithashtu edhe dëshmitari Y. në këtë drejtim deklaroi se i akuzuari gjatë të shtënës nuk ka qenë i penguar nga askush dhe ka pas mundësi që ta vras edhe këtë, nga të gjitha këto të lartë cekura gjykata ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe është ardhë në përfundim që dashja e të akuzuarit ka qenë që viktimës ti shkaktoj lëndime të lehta trupore, andaj edhe në veprimet e të akuzuarit janë formuar të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

Në aktakuze prokurori i shteti pos tjerash ka theksuar se ngjarja ka ndodh rreth orës 17.10 min, kurse gjykata pas administrimit të gjitha provave gjate shqyrtimit gjyqësor, respektivisht nga provat materiale ka vërtetuar se ngjarja ka ndodhur rreth orës 17.30 min, pos tjerash në dispozitiv prokurori i shtetit ka theksuar i akuzuari nga shtëpia merr armen, mirëpo gjykata me asnjë provë të administruar nuk ka vërtetuar rrethanën se i akuzuari armen e ka marrë nga shtëpia, në këtë drejtim kemi vetëm mbrojtjen e të akuzuarit i cili në këtë drejtim deklaroi se armen e kishte me vete nga se gjithnjë e mban me vete, andaj edhe këtë rrethanë gjykata nuk i ka përfshi në diapozeitin e aktgjykimit por në diapozeitin i ka fut rrethana që i ka vërtetuar pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësin penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

DUKE vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit për te akuzuarin, Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 te KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese , për te akuzuarin Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti me pare nuk ka ra ne konflikt me ligjin, shprehjen e keqardhjes për atë që ka ndodhur, sjelljen e tij korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor , gjendjen e vështirë ekonomike, i pa pune jeton nga te ardhurat e realizuara me pune bujqësore , i martuar baba i tre fëmijëve , vlerëson edhe faktin se nga veprimi i te akuzuarit nuk është shkaktuar ndonjë pasoje veçanërisht e dëmshme për jetën dhe shëndetin e te dëmtuarit e këtë duke u bazuar ne faktin se te njëjtit i janë shkaktuar lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme. te cilat gjithashtu kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese, Si rrethane tjetër lehtësuese gjykata pati parasysh se i njëjti qysh ne fillim te hetimeve e në të gjitha procedurat tjera penale , nuk i ka mohuar veprimet e tija por gjatë tere procedurës ka kundërshtua kualifikimin juridik, ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe ne mungese te ndonjë rrethane rënduese, te akuzuarin e ka gjykuar si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi me te cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 te KPPRK-së.

Vendimi qe te akuzuarit ne dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe ne arrest shtëpiak u vendos ne kuptim te nenit 83 te KPRK-se

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është i bazuar ne lartësinë reale te shpenzimeve te shkaktuara për zhvillimin e këtij procesi penal, prandaj gjykata duke u bazuar ne nenin 450 te KPPRK-se te akuzuarin e obligoi ne pagimin e shpenzimeve te procedurës penale dhe te paushallit gjyqësor.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par.3 nën par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036

Vendimin qe gjykata për realizimin e kërkesës pasurore juridike te dëmtuarin e udhëzoi ne kontest te rregullt civile juridik u mur komfor nenit 463 te KPPRK-se.

Nga arsyet e cekura me larte dhe me zbatimin e nenit 365 te KPPRK-se është vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi

DUKE u bazuar ne nenin 368 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr.31/20 me dt. 08.02.2021 i përpiluar me dt.09.03.2021

Sekretarja Juridike
Shpresa Kërnya

Kryetarja e Trupit Gjykses
Lumturije Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE:

K undër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa
në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate
.